

Stinët e zeza të gruas


Është fort e trishtë për ta thënë, por në Shqipëri për vit ekziston një stinë e zezë e gruas, ose një anti-stinë e gruas, ose një stinë anti-grua, sido që ta quajmë atë. Zakonisht nis në qershor kur dielli zë të përzhisë gjithçka, merr hov në korrik dhe nis të shuhet në gusht. Dhe ashtu si në mbarim të stinës, kur frutat e pjekura të pemës bien përdhe, edhe gazetaret nisin të numërojnë gratë e vrara, vetëvrara, plagosura, gjymtuara, të rënë nga pema e jetës pa kafshuar asnjë frut të mëkatit por vetëm ngaqë janë gra. Ia vënë fajin të përjetshmit motiv banal dhe i varrosin nën tituj idiotë: "Gruaja shqiptare në Greqi vetëhelmohet pas zënkës me burrin", "Punëtorja Bedrie L. pi fotoksinë pas bullimit në Tik-Tok", "27 vjeçares i del fotoja nudo, vetëhidhet nga ballkoni", duke mos dëgjuar britmën e tyre të dëshpërimit, duke mos parë dhunën e burrave në martesë të dështuara, duke mos gjykuar për kulturën e

Paraja e pisët, hapa pas në çështjen e emancipimit

Historia na mëson se që gruaja të bëhej e lirë, të shkonte në shkollë, në teatër, në fillim iu desh të arratisesh nga gardhi i fshatit, i arës, i ngujimit në shtëpi dhe të shkonte në fabrikë, në qytet. Të kalonte nga shtëpiake në punëtore që mandej punëtorja të bëhej studente, shkencëtare, artiste, politikane etj. Prej këtij akti zënë fill të gjitha të drejtat e tjera: ajo e votës, e pronës, e individualitetit.

Kësisoj, shkrehja e industrisë tekstile për shkak të parasë së pisët, është hap pas edhe në çështjen e emancipimit. Gruaja që nuk del të punojë rikthehet në gardhet e vjetra të dhunës e papunësisë, izolohet nga qyteti dhe grupi shoqëror, nuk ka pagën e saj, domthenë në fuqinë, zërin, gjasën e lirisë. Rritja e

poshtërimit, ndrydhjes, abuzimit që u rri ngusht si një këmishë force grave të Shqipërisë. Për çudi, nga viti në vit stina zë e zgjerohet, herë nga qershori në dhjetor dhe herë të tjera, si sivjet, nga janari në qershor, aq sa rrezikon të shtrihet në muaj, vite, dekada, madje edhe shekuj dhune dhe padrejtësie. Por kjo stinë e zezë duhet të marrë fund dhe gratë do ti japin fund asaj sepse qoftë edhe me vdekjen e tyre, dëshmojnë se ato po rezistojnë dhe ku rezistohet, sado humbje paçin, fitorja nuk është larg.



Ilustrim nga New York Times

armatës së të papunave shtyp edhe çdo grevë të grave sepse tanimë punëtorët bëhen të zëvendësueshme. Paraja e pisët pra, paraja e burrave të fortë, të korruptuar, po shkatërron gjithçka dhe e vetmja forcë për t'iu kundërvënë është përbashkimi dhe puna e pastër e dhjetra mijëra burrave e grave që ia dalin me krahët e tyre, ndershmërisht dhe besojnë ende tek koncepti i jetës me shpresë dhe drejtësi.

Studim për gjendjen e gruas punëtore në fasoneri: Markat (1)

Sektori fason në Shqipëri, i njohur për prodhimin e kontraktuar të veshjeve dhe këpucëve, ka qenë një nga motorrët kryesorë të rritjes ekonomike të vendit në 10 vjeçarin e fundit. Në fillim të kësaj periudhe, industria fason kontribuonte rreth 5-6% të PBB-së së Shqipërisë, duke ofruar punësim për një pjesë të konsiderueshme të forcës punëtore. Sipas të dhënave zyrtare të Doganës Shqiptare, tekstilet zënë rreth 38% të vlerës totale të eksporteve. Ato përbëjnë 1 nga 3 grup-mallrat kryesore të eksportit (tekstilet, lëkurë-këpuca dhe lëndët minerale). Megjithatë, kriza e vitit 2023 shënoi një pikë kthese të rëndësishme. Pandemia e COVID-19, rënia e monedhës EUR dhe pasojat e saj globale çuan në një rënie të porositve, me një ulje prej rreth 40% në krahasim me vitet e mëparshme. Në këtë kontekst, nevoja për të hedhur më shumë dritë mbi problemet e sektorit fason, lind krejt natyrshëm. Për rrjedhojë, "Instituti për Kritikë dhe Emancipim Shoqëror" tenton të analizojë problemet e këtij sektori dhe të sigurojë të dhëna shkencore mbi shpërndarjen e markave, mbi problemet e këtyre punëtorëve, sidomos me krizën pas pandemisë.

Në këtë numër dhe në vazhdimësi do të shfaqim disa prej gjetjeve kryesore të studimit. Një prej të dhënave lidhej me markat për të cilat prodhohen në vendin tonë, sa i njihnin punëtorët këto marka dhe mënyra se si ishin prezantuar punëtorët me markat që prodhonin për to. Vetëm 61.42% e të anketuarëve janë përgjigjur që i njohin markat, 33.86% janë shprehur se nuk i njohin brendet dhe 4.72% nuk kanë preferuar të shprehen. Nga studimi kuptojmë se sa më e madhe të jetë ndërmarrja, aq më shumë i njohin markat, dhe sa më vogël ndërmarrja, mundësitë që punëtorët t'i njohin markat janë më të ulëta.

Ndërsa përsa u përket ndërmarrjeve të mëdha, janë më të ndërgjegjshme që t'jua prezantojnë vetë punëtorëve markat me të cilat kanë kontrata. Kjo varet re se nga të anketuarit që janë shprehur se i njohin markat, 39.22% kanë thënë se vetë kompania i ka njoftuar. Por përsëri pjesa më e madhe edhe në ndërmarrjet e mëdha, markat i njohin nga etiketat që u vendosin artikujve me 41.18%. Një pjesë e vogël, vetëm 5.88%, i njohin markat nga bisedat me punëtorë. Gjithashtu 13.73% janë punëtorë

që kanë preferuar të mos shprehen se nga i njohin markat duke u shprehur se i kanë njohur nga metoda të tjera ose nuk janë përgjigjur fare.

Në ndërmarrjet e vogla, mund të përmendim se prodhohet për Marelë, Interbule, Markup dhe veshje pune për profesione të ndryshme për vendet evropiane. Këtu vëmë re se këto marka nuk janë shumë të njohura, jo vetëm në vendin tonë, por edhe në vendet evropiane. Ndërsa në ndërmarrje më të mëdha, janë shprehur se po prodhojnë për marka më të njohura. Ndër to mund të përmendim Versace, Prada, Gucci, Fendi, Philipp Plein, Burberry, Valentino, Pirre Candy, Original Marines, Vecense, Primico, Clarks, Timberland, Hollo, Teva, Hogan, Cofra, Siebel, Puma, Adiddas, Grand, Zenus, Damani, Max Mara, Zara, Koton, Versace, Bershka, Asos, Benetton, etj.

Ajo çka varet re është se sa më e madhe të jetë ndërmarrja me punëtorë të punësuar, aq më të njohura dhe të shtrenjta janë markat për të cilat prodhojnë. Kjo varet edhe për faktin se këto ndërmarrje kanë mundësi të konsiderueshme financiare për të investuar në trajnimin e punonjësve dhe për të përmirësuar proceset e punës. Trajnimi i specializuar dhe zhvillimi i aftësive mund të sjellë një nivel të lartë efikasiteti dhe cilësie në prodhim, duke ndikuar në imazhin e markës dhe në rritjen e konkurrencës në treg. Madhësia e ndërmarrjes bën që punonjësit të kenë më shumë mundësi për të zhvilluar aftësi dhe për t'u rritur në detyrat e tyre, duke sjellë një qëndrueshmëri midis interesave të ndërmarrjes dhe të punonjësve.



Robaqepëset e Renato Gattuso-s

Renato Gattuso (Dhjetor 1911 – Janar 1987) është piktor dhe personazh i angazhuar në jetën politike dhe intelektuale italiane të krahut të majtë. Antifashist, përfaqësues parlamentar dhe lëvrues i një arti të ri social, jashtë formave dhe ideve të vjetra, ai pasqyroi jetën e përditshme të klasës punëtore italiane, në ara, në fabrika dhe në mëhallat periferike të qyteteve të mëdha.



Tre këngë kurbeti nga Teki Dervishi

Teki Dervishi (16 janar 1943 - 29 qershor 2011) është shkrimtar dhe intelektual shqiptar nga Kosova, si dhe një nga zërat më të veçantë të letërsisë moderne shqipe. I gjykuar politikisht që 17 vjeç, ai ishte një nga burgosurit më të rinj të burgut famëkeq jugosllav të "Goli Otokut".

Trim i marrë

Në trotuar si beduin si kloshar
në rrugët e botës më zë natë
ngrysem si çifteli e kërlëshur
vruga qepallave hije m'i bën
lirë e shes artin tim – mjeshtërinë
se bukën s'e dua lëmoshë
mëshirë s'e dua dashurinë
asnjë bar nostalgjinë s'ma shëron
re e mllëfur në ballin tim
vetëton e bubullon
më vret dru të njomë
vonesa ime pranverore
do të kthjellet në paanësi e di
në veri atje ku një Doruntinë
psherëtin
e vëlla më pret t'i vij
malli për të boll më del
me leckat e mia vjeshta
rrugëve të planetit kah m'i vjel

Vaterpolisti në bulevard

Në bulevardet me drita ngjyrë fishekzjarresh
më panë me plis të bardhë
me buzë të përvjela më thanë:
"Ja, vaterpolisti në asfalt!"
në kokë më oshëtinte
edhe porosia e sime amë
"Biro, puna fizike sjell leverdi
s'është marre të pastrosh nevojto
ne jemi njerëz të thjeshtë
ti s'je profet
ti s'je për punë krijuese, për lavdi
për punë hyjnore... shpirtërore
nëpër zebrën e kalimtarëve asfaltit ngarendi
e ngreh përdore kazanin me rrotë
mbi një teneqe me prush
në skarë pjek shtalba misri
dimrit pjek gështenja
në Pragë Paris e Stamboll
vjeshtë e dimër
erë bliri kundërmoj
erë vere nga atdheu im
më sjellin kanjushat e mërgimtarëve
të pështjellë me letër-celofan

Eshttrat që vijnë vonë

Prej shtëpisë sime me çati prej kashte
dola me hejben plot vegla
e mora rrugë Veriun e Thellë
kurbet me kobër dola mjeshtër me pagë
pas erës së bukës
rrugë më rrugë shkretëtirës
kah Lindja
kah Perëndimi
latues mermeri me daltë
ikonograf me brushë e ngjyrë
godita pirgjet e larta të botës
gjurmë lash shenjën e qartë
pikturat e amshuara nëpër tempuj
lirikën – fjalë të zjarrtë
aktor me pseudonim
palaço në oborrin mbretëror
pa emër pa datë
disa shekuj pastaj
në Atdhe
eshtrat më vijnë vonë
me anije
– deti çohet dallgë



KRIZË NË FASONERI — KUSH DO TË PAGUAJË? —



Në vetëm dy javët e para të janarit të 2024, sipas Shoqatës së Eksportuesve, mbi 3000 punëtorë të industrisë tekstile janë flakur në rrugë dhe dhjetra fabrikave të vogla e të mesme iu është vënë dryni. Arsyeja është forcimi i monedhës kombëtare, lekut, përballë monedhës europiane dhe arsyeja e këtij forcimi nuk janë as investimet e huaja, as shtimi i eksporteve dhe as rritja e dërgesave nga emigrantët, por paratë e pista të "tregtisë së bananeve".

Sa për shembull, kompania "Picari" me qendër qytetin e Patosit sapo ka pushuar 270 punëtorë. "Imes Alb" në qytetin e Cërrikut ka pushuar 80 punëtorë. "Supreme Bruno" ka pushuar 120 punëtorë, "Donchris" 50 punëtorë, "Sfidal" 100 punëtorë. "Rozimpeks", e themeluar në 1992, ka nxjerrë në asistencë 150 punëtorë. Marka italiane "Cotonella", e cila nuk pushoi së punuari as në 1997, largohet pas 27 vitesh nga qyteti i Shkodrës për tu zhvendosur në Uzbekistan, kurse "Altek" dhe "Kral Shoes" pas shkurtimeve të ndjeshme, ashtu si shumë kompani italiane po e zhvendosin prodhimin e tyre në Tunizi.

Këto janë vetëm disa raste të vogla kompanishë të industrisë tekstile dhe me dhjetra të tjera po falimentojnë, mbyllen dhe pushojnë punëtorët me shpejtësi. Por kush do ta paguajë çmimin e kësaj krize? Qeveria jo, madje me politikat e saj, me ligjet e aministisë së pasasë së pisët, po e shpejton procesin e çindustrializimit. Pronarët jo, pasi gjejnë robëresha të tjera në vendet e botës së tretë për ti zevëndësuar gratë shqiptare. Kush pra? Faturën e krizës, si gjithmonë, si në çdo krizë pandemie dhe lufte, e paguajnë punëtorët, familjet, qytetet dhe vetë Shqipëria.

E vetmja rrugë për ti bërë ballë kësaj krize është bashkimi për rezistencë dhe të drejta i të gjithë punëtorëve, në krye të herës në fabrikat e tekstilit, mandej me punëtorët e sektorëve të tjerë të rrezikuar si në industrinë ushqimore dhe call center dhe në fund, e gjithë klasa e njerëzve të punës, bujq, të rinj, pensionistë, si shumicë dërmuese e shoqërisë që me punën dhe jetën e saj e mban në këmbë mbarë Shqipërinë.